



VENDIM

Nr. 4, date 15/05/2015

Për shpërndarjen e grantit të akorduar Universitetit të Arteve për vitin 2015 me burim financimi buxhetin e shtetit

Keshilli i Administrimit të Universitetit të Arteve, në mbledhjen e tij të hapur të datës 15.05.2015, pasi dëgjoi materialin e hartuar nga Kancelari dhe paraqitur nga Rektori "Për ecurine ekonomike per periudhen Janar-Prill 2015 dhe situatën financiare të UART per vitin 2015", duke vlerësuar menaxhimin e burimeve financiare në dispozicion të Universitetit të Arteve, bazuar në nenin 14, pika 2, germa ç, të Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH", i ndryshuar,

VENDOSI

1. Miratimin e veprimtarisë ekonomike të Universitetit të Arteve për periudhën Janar-Prill 2015
2. Shpenzimet e parashikuara për vitin 2015 për "Paga"(art.600) dhe "Sigurime shoqërore dhe Shëndetësore"(art.601) nuk mund të reduktohen, mbasi janë të domosdoshme për sigurimin e ecurisë së veprimtarisë së Universitetit të Arteve.
3. Shpenzimet e parashikuara për vitin 2015 për "Mallra dhe shërbime"(art.602) nuk mund të reduktohen, përkundrazi, mbasi ato nuk përfshijnë në mënyrë të plote kërkesat për bazën mësimore materiale për mësimdhënie.
4. Duke parë pamundësinë e mbulimit të shpenzimeve të parashikuara me vitin 2015, me buxhetin aktual, të cilin Univesiteti i Arteve ka në dispozicion, Rektoriati ti drejtohet Ministrisë së Arsimin dhe Sporteve për mundësinë e akordimit të një granti shtesë për vitin 2015.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Prof.Asc.Dr.Elida RAPTI - Kryetar

Prof.Dhurata Bozo

- Anëtar

Prof.Najada HAMZA

- Anëtar

Shpresa Hodaj

- Anëtar

Prof.Asoc.Arben BASHA - Anëtar

Erjon Ndoqi

- Anëtar